

611111 Volksschule Pestalozzi Leoben

Kerpelystr.13 | A-8700 Leoben

☎ +43(0)3842/7062-746

📞 +43(0)676/84 4062 746

✉ vs.pestalozzi@gmx.at

🌐 <http://www.schulen-leoben.at/vs-pestalozzi.html>



Die Volksschule mit Profil
Persönlich – vielseitig – zuverlässig

Të nderuar prindër,

kemi lënë pas javë të vështira, por edhe ua kemi dalë mbanë së bashku me ndihmën tuaj. Jo vetëm dyqanet por edhe bizneset u mbyllën në të shumtën e tyre, si edhe shkollat. Mësimet janë zhvilluar në shtëpi. Për t'u përgatitur për vitin e ardhshëm shkollor, vajza/djali juaj mund të mos ketë pasur mundësi të mësojë aq mirë sa në shkollë, ku mësuesit janë gjithnjë pranë nxënësve për t'i ndihmuar, përkrahur e mësuar së bashku me ta.

Ndaj ne ofrojmë shkollën verore, sidomos për vajzën/djalin tuaj gjatë dy javëve të fundit të pushimeve, ku mund të përgatiten për vitin e ri shkollor dhe të përmirësojnë e konsolidojnë aftësitë e tyre në gjermanisht.

Regjistrimi për shkollën verore bëhet përmes formularit të bashkëngjitur të regjistrimit. Pas regjistrimit, ndjekja e shkollës verore është e detyrueshme. Jeni të lutur ta dorëzoni aplikimin maksimumi deri më 22 qershor 2020.

Shkolla verore zhvillohet në pikën e mëposhtme:

Volksschule Pestalozzi Leoben, Kerpelystraße 13, 8700 Leoben

Nëse është e mundur, transporti ose rruga deri në ambientet e shkollës verore duhet të organizohet nga vetë kujdestarët ligjorë. Nëse nuk keni mundësi transporti, na e bëni të ditur në formularin e regjistrimit.

Regjistroni vajzën/djalin! E mirëpresim me dëshirë fëmijën tuaj në shkollën verore. Nëse keni pyetje, mund të më kontaktoni lirisht.

Drejtori i shkollës

VDir. Mag. Alexandra Baumgartner, BEd.

Schulleitung VS Pestalozzi Leoben / VS Leoben Leitendorf



NDËRFUTJE e Fondit të Integrimin

Ka gjithashtu një ofertë për prindërit pranë Österreichischen Integrationsfonds (ÖIF - Fondi Austriak i Integrimin):

Është e rëndësishme për arsimin e mëtejshëm të fëmijës suaj që ta mbështesni fëmijën në mënyrën më të mirë gjatë mësimeve. Si ndihmesë, Fondi Austriak i Integrimin (ÖIF) ofron dhe kurse prindërimi për prindërit e nxënësve që marrin pjesë në shkollën verore. Në to do të merrni informacion të rëndësishëm në lidhje me shkollën verore dhe sistemin shkollor të Austrisë. Kurset për prindër do të ofrohen në të gjitha shtetet federale nga 22 qershori dhe mund të përkthehen në një sërë gjuhësh origjine nëse kërkohet. Pjesëmarrja në kurse është pa pagesë, regjistrimi kryhet përmes www.integrationsfonds.at/elternkurse, me telefon në nr. 01/715 10 51 – 263 dhe në person në të gjitha pikat e integrimin të ÖIF.